REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës:	2019:123383
Datë:	26.02.2024
Numri i dokumentit:	05372373

Ac.nr.9854/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtari Faton Ademi Kryetar i kolegjit, Besnik Bislimaj dhe Hidajete Gashi Alaj anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Biondina Zeneli, në çështjen juridike të paditëses Sh.(A.)A., nga.....të cilën e përfaqëson e autorizuara Z.K, avokate në...., kundër të paditurve L.(D.)P., e lindur....., më parë nga.....,tani me vendbanim të panjohur, të cilën e përfaqëson përfaqësuesja e përkohshme E.S, avokate në ....., P(.Gj.) D., nga..... dhe N.Sh, L.Sh dhe V.Sh, që të tre nga....., të cilët i përfaqëson i autorizuari Veton Berisha, avokat në Pejë, për shkak të vërtetimit të drejtës së pronësië, vlera e kontestit 1.000 euro, duke vendosur në lidhje me ankesën e të paditurit-kundërpaditësit të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë –Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1107/17, i datës 05.10.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 16.02.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e themeltë ankesa e të paditurit P.D, nga....., **PRISHET** aktgjykimi Gjykatës Themelore në Pejë –Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1107/17, i datës 05.10.2021, dhe lënda i kthehet në rigjykim dhe vendosje Gjykatës së shkallës së parë

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.1107/17, i datës 05.10.2021, ka vendosur si në vijim:

"VËRTETOHET se paditësja Sh.(A.)A., nga.....është pronare ngastrës kadastrale me nr...../.., në sip. Prej 315 $m^{2,}$ dhe pjesës së ngastrës kadastrale me nr..../.. në sip. Prej 185 m^2,e në sip. Të tërsishme prej 500$m^{2.}$

DETYROHEN të paditurit: L.(D.)P., e lindur....., më parë nga .....,tani me vendbanim të panjohur, të cilën e përfaqëson përfaqësuesja e përkohshme E.S, avokate në ...., P. (Gj.) D., nga....., N.Sh, L.Sh dhe V.Sh, që të tre nga....., që paditëses t'ia njohin të drejtën e pronësisë, siç është cekur në pjesën I të këtij dispozitivi, dhe të lejojnë që në emër të saj si pronare të bëhet regjistrimi i kësaj paluajtshmërie, në Regjistrin e të drejtave të patundshmërive, në Zyrën Komuanle Kadastrale, në

2021:269156

Pejë, në afat prej 15 ditësh, nga dita emarrjes së këtij aktgjykimi e në kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale."

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit të paraparë ligjor ankesë ka parashtruar i padituri P.(Gj.)D., kundërpaditësi për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e shkallës së dytë të shqyrtoj shkresat e lëndës dhe këtë ankesë dhe të marrë aktgjykim me të cilin lënda e Gjykatës Themelore në Pejë C.nr.1107/17, i datës 05.10.2021, të prishet dhe e njëjta lëndë të kthehet edhe një herë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Ankesa e të paditurit i është dorëzuar të autorizuarës të palës paditëse por e njëjta nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit, si Gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurit është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës, vërtetohet se paditësja ka parashtruar padi me datë 17.10.2017 pranë Gjykatës së shkallës së parë për vërtetim të pronësisë, vlera e kontestit 1.000 euro, më konkretisht me arsye sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vendosur sipas padisë së paditëses, pas administrimit të provave dhe vlerësimit të gjendjes faktike ka marrë aktgjykimin, C.nr.1107/17, i datës 05.10.2021, duke vërtetuar se paditësja është pronare e ngastrës kontestuese kadastrale, dhe duke vendosur më decidivisht sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit të ankimuar ka konstatuar se nga provat e administruara nuk janë bërë jo kontestuese faktet se paditësja është në posedim të papenguar të patundshmërisë që nga viti 1978-80 dhe se e paditura e parë L., i'ia ka shitur pronën lëndore bashkëshortit të paditëses, po ashtu nuk ishte kontestues fakti se nga DGJK për pronën lëndore ka ndodhur gabimi teknik dhe ajo është bartur në emrin e të paditurve 2,3,4 dhe 5, ku gabimisht është regjistruar prona në emër të tyre. Gjykata ka vërtetuar se paditësja Sh.(A.)A.me bashkëshortin tani të ndjerë O.A, ka blerë pronën lëndore nga e paditura L.(D.) P., ngastrën kadastrale me nr...../.., në sipërfaqe prej 315 m^2 dhe pjesës së ngastrës kadastrale me nr..../.. në sipërfaqe prej 185 $m^{2,}$ e në sipërfaqe të tërësishme prej 500 m^2. Në vitin 1980 paditësja me bashkëshortin në këtë pronë ka ndërtuar objektin e banimit të tipit përdhesë dhe prej atëherë nuk ka pasur asnjë ndryshim, e në të cilin objekt jeton paditësja me familjen e saj. Po ashtu, Gjykata ka vërtetuar faktin se gabimisht kjo pronë, me një gabim kadastral ka kaluar në emër të paditurve P.D dhe atë ngastra kadastrale me nr..../.. në sipërfaqe prej 315 m^2 dhe N.Sh, L.Sh dhe V. Sh dhe atë ngastra kadastrale me nr...../.. në sipërfaqe prej 185 m^2, ku të dyja këto pjesë përbëjnë sipërfaqen e tërësishme prej 500m^2 e që paraqet pronën faktike të paditëses Sh.A. Gjykata ka vërtetuar faktin se të paditurit P., N., L. dhe V. nuk kanë pretendime në këtë pronë, pasi që e kanë kuptuar se ka ndodhur gabimi teknik kadastral lidhur me bartjen e kësaj prone dhe kanë dijeni se paditësja me familjen e saj jeton aty mbi 40 vite, gjithashtu kanë dijeni se nuk është penguar nga askush. Si dhe është vërtetuar në bazë edhe të dëshmive të dëshmitarëve B.M dhe Q.A se shitblerja ka ndodhur dhe se paditësja me familje ka jetuar aty pa pengesa nga e paditura L. apo kushdo tjetër dhe se aty është mbi 40 vite, pagesën e ka bërë nga pronat që i ka pasur në fshat, si dhe në arsyetim theksohet se L. është larguar prej aty kur e ka marrë çmimin e shitjes e që ka qenë pengesë për t'u bartë prona në emër të paditëses.

2021:269156

Gjykata ka konstatuar se paditësja e ka fituar të drejtën e pronësisë dhe me mbajtje të ndërgjegjshme konform dispozitave të nenit 40 par.1 të Ligjit mbi Pronësinë dhe të Drejtat e Tjera Sendore.

Vendimin mbi shpenzimet e ka marrë konform nenit 463 par.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e Kosovës nuk e pranon vlerësimin dhe përfundimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktgjykimi i atakuar me ankesë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n), nenit 182.1 lidhur me nenin 160 par.3, lidhur me nenin 160 par.4 të LPK-së, nenit 182.1 lidhur 76 dhe 264 të LPK-së, gjendja faktike nuk është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, si dhe e drejta materiale është zbatuara në mënyrë të gabuar .

Qëndron pretendimi ankimor i palës së paditur se aktgjykimi i atakuar është në kundërshtim me nenin 182.2 pika n) sepse dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është i pa qartë, jo i plotë, i pa përshtatshëm për përmbarim. Mënyra se si është hartuar dispozitivi i aktgjykimit të atakuar i njëjti nuk mund të përmbarohet sepse nuk dihet shtrirja dhe përkufizimi i pjesëve të ngastrave për të cilat paditësja është bërë pronare, pastaj nuk dihet zona kadastrale, gjë që si e tillë prapë nuk mund të regjistrohet. Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar i cili është më tepër përshkrues sesa analitik, nuk janë dhënë arsye të qëndruehsme për faktet vendimtare edhe ato që janë dhënë janë të mangëta, pastaj për procedurën provuese, cilave prova u'a ka falur besimin Gjykata dhe pse dhe cilave prova nuk ua ka falur besimin po ashtu pse.

Me nenin 160 par.3 të LPK-së përcaktohet se: "Dispozitivi i aktgjykimit përmban: vendimin me të cilin aprovohen apo refuzohen kërkesat e veçanta që kanë të bëjnë me çështjen kryesore dhe kërkesat aksesore, vendimin për ekzistimin apo mosekzistimin e kërkesës së parashtruar me qëllim kompensimi të saj me kërkesëpadinë si dhe vendimin mbi shpenzimet procedurale."
Dispozitivi I aktgjykimit të atakuar sikurse u tha më lartë për shkak të mangësive është në kundërshtim edhe me nenin 160 par.3 të LPK-së.

Me nenin 160 par.4 të LPK_së përcaktohet *se: "Arsyetimi i aktgjykimit përmban: kërkesat e palëve, faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar, cilat nga faktet e tilla i ka vërtetuar, pse dhe si i ka vërtetuar ato fakte, e po që se i ka vërtetuar me anë të provave, cilat prova i ka shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar ato".*

Arsyetimi i aktgjykimit të atakuar nuk është I ndërtuar mbi këto premise, pasi nuk ka analizë të fakteve dhe vërtetim të fakteve me prova konkrete, ka përshkrim, pastaj nuk janë dhënë arsye bindëse se cilat fakte me cilat prova I ka vërtetuar, pse dhe si I ka vërtetuar.

Me nenin 76 të LPK-së përcaktohet se: "*Gjatë tërë procedurës Gjykata duhet të kujdeset, sipas detyrës zyrtare, nëse personi që paraqitet si palë mund të jetë palë në procedurë dhe nëse është me zotësi procedurale, nëse palën me pazotësi procedurale e përfaqëson përfaqësuesi i saj ligjor, dhe nëse përfaqësuesi ligjor ka autorizimin e veçantë, kur ai është i nevojshëm."*

Me nenin 264 të LPK-së përcaktohet se: "*Padia mund të ngrihet bashkërisht nga shumë paditës ose kundër shume të pa diturve (bashkëndërgjyqesia) në rast se: a) në pikëpamje të objektit të kontestit*

2021:269156

janë në bashkësi juridike apo nëse të drejtat e tyre, përkatësisht detyrimet, burojnë nga e njëjta bazë faktike apo juridike (bashkëndërgjyqësia materiale)".

Në rastin konkret padia që nga fillimi është paraqitur vetëm nga paditësja Sh.A, ndërsa në shkresat e lëndës janë dy deklarata të dhëna tek noteri nga dy djemtë e paditëses se ata hjekun dorë nga e drejta e tyre në favor të nënës, por që në rastin konkret nuk bëhet fjalë për hapje të trashëgimisë, por për padi për vërtetim pronësie e të cilët fare nuk figurojnë si paditës. Është e pa qartë se prona a është blerë nga ish burri i ndjerë i paditëses apo nga familjarët e burrit siç pretendon i padituri me ankesë, sepse duhet bërë dallime në mes të bashkëndërgjyqësisë unike, formale dhe materiale, gjë që Gjykata ka qenë dashur që të ekzaminojë padinë edhe në këtë drejtim se mundet me qenë palë paditëse vetëm paditësja, dhe se a mund të hjekun dorë pa qenë fare palë në procedurë dy djemtë e paditëses, këto janë çështje që fare nuk janë sqaruar nga Gjykata e shkallës së parë.

Gjykata e shkallës së parë nuk ka vërtetuar drejtë edhe në mënyrë të plotë as gjendjen faktike, sepse dy dëshmitarët e proceduar njëri në kohën kur pretendohet se ka ndodhur shitblerja ka qenë në moshën 4 vjeçare dhe tjetri është kushëri i burrit të ndjerë të paditëses, ka qenë dashur që ndokush prej fqinjëve të dëgjohet në cilësi të dëshmitares për të vërtetuar faktin e posedimit dhe kohës së posedimit të paditëses apo edhe familjarëve/ burrit të saj në pronën kontestuese.

Si rezultat i shkeljeve të dispozitave të procedurë, vërtetimit të mangët dhe jo të plotë të gjendjes faktike ka ardhur deri te zbatimi i gabuar i të drejtës materiale.

Gjykata ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat e Tjera Sendore mirëpo padia evidenton se periudha e mbajtjes apo posedimit i referohet kohës kur ka qenë në fuqi Ligji mbi Marrëdhëniet Themelore Juridiko Pronësore.

Në riprocedurë Gjykata e shkallës së parë udhëzohet që të eliminojë të metat që e kanë shoqëruar atgjykimitn e atakuar të evdientuar si më lartë, të vërtetojë drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, të marr vendim të drejtë dhe të sigurohet që i njëjti me qenë në përputhje me kërkesat nga neni 160 i LPK-së.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 pika (c) e LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.9854/2021, me datë 16.02.2024

Kryetari i kolegjit - Gjyqtari
***Faton Ademi* d.v**

2021:269156